

Lejet e ndërtimit


Tremujori I, 2019

Tiranë, më 31 Maj 2019: Në tremujorin e parë 2019, janë miratuar gjithsej 245 leje ndërtimi për ndërtesa të reja, nga 221 leje të miratuara në tremujorin e parë 2018, duke shënuar një rritje prej 10,9 %.

Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja, në tremujorin e parë 2019, është rreth 581.236 m², nga rreth 200.944 m² miratuar në tremujorin e parë 2018, duke shënuar një rritje me rreth 2,9 herë.

Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike, në tremujorin e parë 2019, është 25,2 miliardë lekë, nga 10,2 miliardë lekë miratuar në tremujorin e parë 2018. Ky tregues në tremujorin e parë 2019, krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë, u rrit me rreth 2,5 herë.

Fig. 1 Struktura e vlerës së përafërt të lejeve të ndërtimit



Tab. 1 Lejet e ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike, T1 - 2019

Llojet e Ndërtimeve	Numër	Sipërfaqe m ²	Ndërtime të reja 000 / lekë	Rikonstruksione 000 / lekë
Gjithsej			23.324.286	1.892.468
I. Ndërtesa	245	581.236	21.005.509	822.910
1.Ndërtime për banim (rezidente)	161	218.255	8.036.912	255.873
a. Me një kat	44	5.571	170.844	60.761
b. Me dy kate	82	17.128	533.492	113.500
c. Me tre ose më shumë kate	28	158.419	5.744.310	81.421
d. Rezidenca për komunitetet	7	37.137	1.588.266	191
2.Ndërtesa të tjera (jo rezidente)	84	362.981	12.968.597	567.037
a. Hotele dhe të ngjashme	28	285.661	9.910.464	31.282
b. Ndërtesa për zyra	1	2.282	97.360	520
c. Ndërtesa tregtare	17	22.802	1.304.216	10.633
d. Ndërtesa industriale	22	43.687	1.356.239	87.429
e. Ndërtesa të tjera	16	8.549	300.318	437.173
II. Punime inxhinierike			2.318.777	1.069.558
1. Infrastruktura e transportit; Rugë e autostrada			117.013	464.394
2. Linjat e ujësjellësave,elektrike dhe telekomunikacionit			2.168.697	142.290
3. Ndërtime komplekse në kantieret industriale			0	0
4. Punime të tjera inxhinierike			33.067	462.874

* Të dhënat për numrin dhe sipërfaqjen e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

Tab. 2 Numri i lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja

Qarqet	I - 18	II - 18	III - 18	IV - 18	I - 19
Shqipëria	221	270	343	360	245
Berat	4	8	20	12	7
Dibër	7	6	16	5	1
Durrës	23	38	51	44	26
Elbasan	19	10	30	29	24
Fier	33	32	34	30	20
Gjirokastër	4	7	13	16	8
Korçë	15	26	24	35	17
Kukës	0	1	2	3	1
Lezhë	10	18	10	19	24
Shkodër	19	14	27	29	8
Tiranë	65	99	104	120	94
Vlorë	22	11	12	18	15

* Të dhënat për numrin e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

Tab. 3 Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja

Qarqet	I - 18	II - 18	III - 18	IV - 18	I - 19
Shqipëria	200.944	292.895	330.725	618.219	581.236
Berat	539	8.868	5.702	13.571	3.089
Dibër	1.195	1.973	3.671	1.189	681
Durrës	26.068	17.634	81.802	47.154	21.580
Elbasan	6.735	2.391	8.061	16.978	18.836
Fier	16.174	11.616	26.977	6.572	14.062
Gjirokastër	6.506	1.429	2.530	6.520	1.448
Korçë	6.754	7.683	5.957	20.380	4.182
Kukës	0	320	2.423	740	359
Lezhë	1.545	3.273	3.126	14.585	26.567
Shkodër	17.384	7.322	9.123	26.211	2.543
Tiranë	103.507	214.636	165.725	456.480	479.954
Vlorë	14.537	15.750	15.628	7.839	7.935

* Të dhënat për sipërfaqen e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

Tab. 4 Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike

Qarqet	I - 18	II - 18	III - 18	IV - 18	I - 19
Shqipëria	10.213.625	11.426.712	15.240.853	22.140.540	25.216.754
Berat	113.402	634.464	302.057	584.440	215.209
Dibër	107.118	73.361	220.312	87.914	22.863
Durrës	897.135	577.965	2.700.649	2.093.900	692.523
Elbasan	265.769	715.010	1.065.704	599.773	1.034.810
Fier	618.398	608.423	3.159.743	1.354.519	931.316
Gjirokastër	421.983	41.217	105.838	333.949	222.707
Korçë	283.634	581.727	261.501	853.060	455.475
Kukës	0	10.554	122.175	34.626	11.800
Lezhë	48.235	82.900	212.870	495.780	2.862.205
Shkodër	985.424	749.499	374.712	1.039.427	735.623
Tiranë	3.366.997	6.762.677	6.361.955	14.329.332	17.678.507
Vlorë	3.105.530	588.915	353.337	333.820	353.716

* Vlera e përafërt përfshin vlerën e ndërtimeve të reja dhe rikonstrukcioneve.

Metodologjia

Përkufizime

Leja e ndërtimit është një autorizim për të filluar punë mbi një projekt ndërtimi. Leja është faza përfundimtare për planifikimin dhe autorizimin e ndërtimit përpara fillimit të punës.

Ndërtesat janë struktura të mbuluara të cilat mund të përdoren të ndara të ndërtuara për qëllime të përhershme, të përshtatshme për mbrojtjen e njerëzve, kafshëve ose objekteve. Ndërtesat klasifikohen në dy lloje të ndryshme kategorish: 1) Ndërtesa për banim (rezidente), 2) Ndërtesa të tjera (jo rezidente), ku përfshihen ndërtesat për hotele dhe të ngjashme, ndërtesa për zyra, ndërtesa industriale, ndërtesa tregtare, etj.

Sipërfaqja është hapësira gjithsej në metra katrorë ku do të vihet në zbatim projekti i miratuar.

Punime Inxhinierike janë të gjitha ndërtimet të pa klasifikuara në ndërtesa: hekurudhat, rrugë, autostrada, ura, linja ujësjellësash, linja elektrike dhe telekomunikacioni, etj.

Klienti është personi ose organi i cili kryen ndërtimin.

Burimi i të dhënave

Burim administrativ, të dhënat grumbullohen nga zyrat statistikore rajonale pranë bashkive përkatëse.